



Pranuar / Dorezuar Prijmjenos/Prodato Received/Delivered	01.09.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednitsa Orgj /Unit	Hi Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	5921/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1016/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- Kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Ilire Mehmeti-Shaqiri- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1016/2023 të datës 20.07.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, me adresë Rr. _____ fshati Zhabar në Komunën e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.08.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1016/2023 e datës 20.07.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushteti Lokal sipas Ndryshim dhe Plotësim të Akt Emërimit të datës 13.11.2013, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5313/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimit administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me ndryshimin e titullin tw vendit të tij të punës nga Zyrtar i Monitorimit të Komunave në Zyrtar i Lartë për Monitorim tw Komunave respektivisht lidhur me kategorizimin e pozitës së tij të punës në Kategorinë Profesionale 2, si dhe kundër ndalesës së shumës së caktuar të hyrave nga paga për shkak të kategorizimit të pozitës se tij gabimisht në Profesional 1.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa Këshilli më datë 01.08.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokolli 1016/2023 nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e palejuar, sepse*

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit të datës 13.11.2013 rezultoi se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *“Zyrtar i Monitorimit të Komunave”*, në Divizionin e Monitorimit të Komunave/Departamentin Ligjor dhe për Monitorimin e Komunave, në kuadër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me koeficient të pagës shtatë (7), sipas sistemit të vjetër të pagave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara ka konstatuar se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë ankuesin e ka kategorizuar në Kategorinë Profesionale 1 me koeficient të pagës pesë pikë shtatëdhjetë e pesë (5.75), ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Administrimit të Pushtetit Lokal me datën 10.05.2023 ka pranuar korigjimet nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë-MPB, që lidhet edhe me pozitën e ankuesit ku ka kërkuar që i njëjti të kategorizohet në Profesional 2 me koeficient të pagës pesë pikë dy (5.2). Tutje me ekuivalentimin e pozitës së tij të punës nga Departamenti i Menaxhimit të Zyrtareve Publikë ankuesi nga muaji Shkurt 2023 pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik dhe ekuivalentimit të pagave nga sistemi i vjetër në sistemin e ri për 3 muaj konkretisht për muajin (shkurt, mars dhe prill) ka pranuar të hyra sipas koeficientit të pagës pesë pikë shtatëdhjetë e pesë (5,75), gjegjësisht sipas përgjigjes së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ankuesi ka pranuar gjithsejtë 173.25 Euro më shumë për shkak të kategorizimit gabimisht nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal e ka njoftuar ankuesin se do ti realizohet ndalesa prej 173.25, në muajin Maj të vitit 2023.

Ankuesi, me datë 20.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e ka kategorizuar ankuesin në Kategorinë Profesionale 2, ndërsa i njëjti ka kërkuar ndryshimin nga kategoria aktuale në Kategorinë Profesionale 1. Gjithashtu ankuesi ka kërkuar ndryshimin e titullit të vendit të punës nga pozita aktuale *“Zyrtar për Monitorimin e Komunave”*, në *“Zyrtar i Lartë për Monitorimin e Komunave”*, dhe rrjedhimisht ti rimbursohen mjetet për muajin (shkurt, mars dhe prill) për vitin 2023.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj"*, dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1016/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI


Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.